



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.547/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Ali Tafarshiku Anëtar i Kryesisë nga subjekti politik ALTERNATIVA dega në Gjakovë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërin e Kosovës (AAK) dega në Gjakovë, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa lejuar ankesa e parashtruar nga Ali Tafarshiku Anëtar i Kryesisë nga subjekti politik ALTERNATIVA dega në Gjakovë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 28.10.2017 nga Ai Tafarshiku Anëtar i Kryesisë nga subjekti politik ALTERNATIVA dega në Gjakovë i cili pretendon se duke u bazuar në rezultatet preliminare të KQZ-së dhe numërit të pa vlefshëm të fletvotimeve, ku në 144 vendvotime (VV) në Gjakovë janë 3295 fletvotime të pa vlefshme, prandaj PZAP-in e ka njoftuar se dyshojmë për keqpërdorim dhe manipulim të rezultateve dhe ka kërkuar verifikim të votave të pa vlefshme.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankeses gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli i PZAP-it, nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsit në 144 vendvotime (VV) në Gjakovë, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës.

Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankuesit Ali Tafarshiku, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZLAnr.547/2017 më datën 31.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.